

07-09-2014



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE VLORE

Nr 843 Akti

Regj.02.04.2014

Nr Vendimi 943

Date 20.06.2014

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

Sot me date 20.06.2014 Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore e
verbere nga gjyqtari **KEN DHIMA**, asistuar nga sekretaria gjyqesore Kamila Petriti,
hqyrtoi ne seance gjyqesore me dyer te hapura ceshtjen civile me **nr 843 akti** date
02.04.2014 qe i perket:

PADITES:

Artan Kadhe, i biri i Epiros, me dtl. 11/06/1971, i
regjistruar me NIPT K 82727406 U, me seli fshati Clirim,
ish fabrika e tullave Fier, i perfaqesuar ne gjykim nga
av. Syrja Zeneli.

PADITUR:

Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Fier, ne mungese.
Drejtoria e Apelimit Tatimor ne Drejtorine e Pergjithshme
te Tatimeve Tirane, Rr. "Gjin Bue Shpata", godina e ish
maternitetit Tirane, ne mungese.

Objekti:

Shfuqizim akti administrative "Njoftim vleresimi tatimor
nr. 11950/3, date 21/11/2013 "i Drejtorise Rajonale Fier.
Shfuqizim I aktit administrative "Vendim nr. 22011/1,
date 06/03/2014" i Drejtorise se Apelimit Tatimor, I cili
ka lene ne fuqi Njoftim vleresimin tatimor nr. 11950/3,
date 21/11/2013 I Drejtorise Rajonale Fier.

baza Ligjore :

Neni 32/a, 154, 156 i K.Pr.Civile, nenet 7, 11, 15, 17 te
Lighit nr.49/2012"Per organizimin dhe funksionimin e
Gjykatave Administrative dhe gjykimin e
mosmarreveshjeve administrative", neni 115 e vijues i

K.Pr.Administrative, Ligji nr. 9920, date 19/05/2008"Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, pika 107, 109, 114.

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te zhvilluar me dyer te hapura gjykata pasi degjoi paditesin i cili kerkoi pranimin e padise sipas objektit dhe pasi shqyrtoi provat e administruara ne dosje dhe bisedoi ceshtjen ne teresi, si perfundim,

VEREN

Se para Gjykates Administrative te Shkalles se pare Vlore paditesi Artan Kadhe ka paraqitur nje padi me objekt dhe baze ligjore si me siper. Gjykata cmon se ka juridiksion per gjykimin e kesaj ceshtjeje pasi per ceshtjen ne gjykim nuk parashikohet ne aktet ligjore e nenligjore ne fuqi ankim ne nje organ me te larte por drejtpersedrejt ne gjykate. Gjykata cmon se kjo padi eshte ne kompetencen funksionale te kesaj gjykate konform nenit 10 te Ligjit Nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative". Gjykata cmon se eshte ne kompetencen lendore te kesaj gjykate shqyrtimi i kesaj ceshtjeje pasi padia eshte nje prej atyre te parashikuara ne nenin 7 pika "ç" te Ligjit Nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative". Gjithashtu gjykata cmon se eshte ne kompetencen tokesore te kesaj gjykate shqyrtimi i kesaj ceshtjeje sipas nenit 11 pika 1 te Ligjit Nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative". Ne rastin konkret te paditur jane Drejtoria Rajonale e tatimeve Fier dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor, Tirane. Nga provat e administruara ne seance gjyqesore ka rezultuar se paditesi Artan Kadhe eshte nje tatimpagues i rregullt, i regjistruar ne Q K R me nr.nipt. K 2727406 U. Gjate gjithë veprimtarise se tij ekonomike nuk ka patur asnje rast te mospagimit apo qofte edhe vonesave te detyrimeve tatimore. Ky fakt eshte i verifikueshem lehtesisht nga te dhenat e cdo subjekti privat online ne websitet e Drejtorise se tatimeve. Gjykata konstaton se njoftim vleresimi nr. 11950, date 21.11.2013, me ane te te cili paditesi detyrohet te paguaje gjoben prej 250 000 leke, bazohet mbi nje akt konstatimi me nr. Serie 0396451, date 29.10.2013, I mbajtur nga inspektoret e verifikimit ne terren te Drejtorise Rajonale Tatimore Berat. Inspektoret ne fjale

kontroll ne mjetin e paditesi me targa AA 208 AF, me drejtes
Dhima, por gjate ushtrimit te ketij kontrolli odo gjë ka qene ne se
i tyre se shtetasi Fatjon Dhima eshte i parregjistruar si i
e paditesit, ne Drejtorine Rajonale Tatimore Fier nuk
dy dokumente te cilat vertetojne regjistrimin e ketij
ne subjektin e paditesit sipas ligjit nr.9920, date 19.5.2008 (i
nr.24, date 2.9.2008, te Ministrise se Financave, te cilat
te beje regjistrimin e punonjesve. Keto dokumenta jane:
Individuele e Punes e lidhur ne daten **27.10.2013** midis paditesit si
shtetasit Fatjon Dhima si punemarres.

"Punëgjara e te punesuarve rishtas dhe te larguarve nga puna" e leshuar nga
Inspektoriati Shteteror i Punes, Dega Fier, e firmosur nga punonjesi pergjegjes dhe
ne daten 27.10.2013, date kur u dorezua kontrata individuale te punes per
te deklaruar ne kete zyre. Ne kete dokument eshte shkruar qarte qe **marredheniet**
se punemarresit Fatjon Dhima kane filluar ne daten 28.10.2013.

Ne Vendimin e Drejtorise se Apelimit Tatimor ne Drejtorine e Pergjithshme te
Tatimeve Tirane, faktet paraqiten te shtremberuara, kur shkruhet: " Tatimpaguesi
kryer deklarimin per punonjesin Fation Dhima me daten 28.11.2013 ne
Listpagesen E SIG 025, per muajin tetor 2013, te deklaruar prane organit tatimor ",
qe qe ne fakt eshte ndryshe. **Tatimpaguesi e ka deklaruar te punesuarin ne**
daten 28.10.2013 e po ne kete date sipas deklarimit E - SIG 027, konfirmohet
se punonjesi ka filluar pune me 28.10.2013, data e ketij konfirmimi eshte
29.10.2013.

Sipas deklarates me nr. E-SIG 025, Listpagesa e kontributeve, konstatohet mjaft
qarte se paditesi ka filluar pagesat e sigurimeve shoqerore per te punesuarin Fatjon
Dhima qe ne muajin tetor 2013 e per muajin nentor e dhjetor jane kryer keto
pagesa sipas Formularit te Deklarimit dhe pageses se kontributeve te derdhura ne
bankë. Me kete dokument bie pretendimi se per tremujorin e katert nuk jane kryer
keto pagesa.

Pretendimi tjeter eshte se serveri qendror i tatimeve nuk ka funksionuar e per
medhoje mund te jete vonuar deklarimi i punonjesit. Gjykata ka konstatuar se ne
praktiken e perditshme shpesh here serverat e institucioneve te ndryshme mund te
bllokohen dhe ate dite keshtu mund te kete ndodhur, por ky fakt nuk e ngarkon me
te paditesin, pasi ai ne menyren shkresore, jo online e ka bere regjistrimin e
punonjesit sic u provua gjate gjykimit. Ne Vendimin e Apelimit per kete fakt
thuhet se nuk mund te vertetohet se punonin apo nuk punonin ne ate moment
serverat e drejtorise se tatimeve e per kete barren e proves ja ngarkon paditesit. Kjo
me te prove jo vetem qe nuk i takon paditesit, por eshte aq e veshtire per tu provuar
me edhe punonjesve te grupit te kontrollit te Drejtorise se Tatimeve Berat ju deshen
plot 5 ore per te konfirmuar te dhenat tatimore te te subjektit qe po kontrollohin ne

datën 29.10.2013, vetëm për faktin se serverat funksiononin me ndërprerje. Për mëtejshme malli i paditës dhe i punësuar se bashku me mjetin ngelen të bllokuara në dorë të drejtorit.

Pretendimisht, gjykata anash se duhet të vendose praninë e kërkesës si të mbështetur në prova dhe në ligj duke vendosur shfuqizimin e aktit administrativ, "Njoftim vlerësimi tatimor" nr. 11950/3, datë 21.11.2013, të Drejtorisë Rajonale Fier dhe shfuqizimin e aktit administrativ "Vendimi nr. 22011/1, datë 06/03/2011 të Drejtorisë së Apelit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë. Gjikata hedh poshtë pretendimin e palës të paditura si të mbështetur në prova dhe në ligj.

Megjithatë vlera e objektit të paditës është me e vogël sesa njëzetfishi i pages minimale në shkallë vendi atëherë ndaj këtij vendimi nuk lejohet ankimi konform nenit 45 të Ligjit nr. 49 datë 03.05.2012, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative" dhe ai është i formës së prirë.

Per Keto Aresye

Gjykata bazuar në Neni 32/a, 154, 156 i K.Pr.Civile, nenet 7, 11, 15, 17 të Ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative", neni 115 e vijues i K.Pr.Administrative, Ligji nr. 9920, datë 19/05/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pika 107, 109, 114.

VENDOSI:

1. Praninë e kërkesës si të mbështetur në prova dhe në ligj.
2. Shfuqizimi i aktit administrativ "Njoftim vlerësimi tatimor nr. 11950/3, datë 21/11/2013" i Drejtorisë Rajonale Fier.
3. Shfuqizimin e aktit administrative "Vendim nr.22011/1, datë 06/03/2011 të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.
4. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës të paditura solidarisht.
5. Urdhërohet zyra e përbarimit me ekzekutimin e këtij vendimi nga dita që vendimi të marrë formë të prirë.
6. Ndaj këtij vendimi nuk nxirret urdher ekzekutimi.
7. Kunder këtij vendimi nuk lejohet ankimi konform nenit 45/b të Ligjit nr.49 datë 03.05.2012, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative" dhe ai është i formës së prirë.

shpall ne Vlore, sot me dt.20.06.2014.

EKRETARE
AMILA PETRITI

GJYQATAR
KEN DHIMA